

EVENTE

- SIGAL UNIQA forum mbi sigurimet me studentët e Prishtinës

- Edukimi Financiar në Shqipëri

- SIGAL UNIQA në Panairin Kombëtar të Punës

Marketing&Pergjegjësi sociale

- SIGAL UNIQA promovon Shqipërinë

- “Mbrotjtja e të dhënave personale”

- “Festojmë për Gjergj Kastriotin”

TREGU I SIGURIMEVE

- TE DHENAT NGA AMF PER PERIUDHEN JANAR-PRILL 2018, SIGAL UNIQA UDHEHEQ TREGUN

EVENTE

SIGAL UNIQA forum mbi sigurimet me studentët e Prishtinës



Në kuadër të informimit dhe edukimit të brezit të ri me sigurimet, Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Group Austria ishte i ftuar në një bashkëbisedim me studentët e UBT-Higher Education Institution në Prishtinë.

Z. Ponari foli për historikun dhe potencialin e tregut të sigurimeve në Kosovë-Shqipëri dhe gjithë rajonin, dhe nënvizoi faktin që tregu i sigurimeve është ende i pazhvilluar në rajonin tonë, me 35 euro për frymë në vit për Shqipërinë dhe Kosova me 43 euro për frymë.

Nisur nga kjo, mbetet një hapësirë shumë e madhe për të zhvilluar tregun e sigurimeve në rajonin tonë dhe duhet shumë punë nga ana e institucioneve përkatëse dhe nga vetë operatorët e tregut për të rritur edhe ne standartet e vendeve të tjera të Europës.

Sfidë e madhe mbetet edukimi i qytetarëve, veçanërisht i brezave të rinj me sigurimet, për ti parë ato si një domosdoshmëri dhe si një mënyrë për të patur një standart jetese dhe jo si taksa.

Një rol të madh kanë edhe qeveritë përkatëse sa i përket hartimit dhe implementimit të ligjit të sigurimeve, ligji i cili përfshin edhe funksionimin e sistemit Bonus-Malus apo incentivave të tjera që nxisin zhvillimet e tregjeve përkatëse në Shqipëri dhe Kosovë.

Nga ana tjetër, Z. Ponari foli edhe për mundësitë e mëdha që ka industria e sigurimeve për punësim, dhe inkurajoi të rinjtë që përveçse të mësojnë dhe studiojnë rreth sigurimeve edhe të fillojnë të mendojnë për të punuar në këtë industri, pasi ka një potencial të lartë.


Edukimi Financiar në Shqipëri



U zhvillua në Tiranë Konferenca Kombëtare “Edukimi financiar” në fokus të së cilës ishin studentët të cilët u përfaqësuan me punime të ndryshme mbi sigurimet dhe pensionet private. Në takim morën pjesë përfaqësues të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare, përfaqësues të industrisë së sigurimeve, student të universiteteve të ndryshme etj.

Gjatë fjalës së tij Z. Naim Hasa Drejtor i Fondit të Pensioneve Private [SIGAL UNIQA](#) u ndal në rolin që ka edukimi financiar në zhvillimin e mëtejshëm të tregut të sigurimeve, gjithashtu dhe vlerësoi një prej studenteve për punimin më të mirë.

Në fund të takimit, u vlerësuan punimet më të mira të disa prej studentëve me çmime të ndryshme.



SIGAL UNIQA në Panairin Kombëtar të Punës

Nën sloganin ‘Mendo skuadren, ndërto të ardhmen’ SIGAL UNIQA mori pjesë në panairin më të fundit të punësimit, në datën 1 maj, i cili u zhvillua në qendër të kryeqytetit, në Sheshin Skënderbej’.

Stenda u vizitua edhe nga Kryeministri Edi Rama, i cili ndaloj për pak çaste për të biseduar me përfaqësuesit e SIGAL UNIQA Group Austria në lidhje me kërkesat e qytetarëve për punësim si dhe mundësitë që ofron kompania për të punësuar individë të kualifikuar.

Mbi 1200 punonjës dhe agjentë janë tashmë pjesë e stafit tonë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni dhe dhjetra të tjerë aplikuan në panairin e punësimit 2018.

Marketing & Përgjegjësi Sociale



“GIRO DEI TRE MARI”
organizohet me mbështetjen
e kompanisë
NR 1 të sigurimeve në Shqipëri!



SIGAL UNIQA promovon Shqipërinë

“Giro Dei Tre Mari Albania” kështu titullohet maratona e të apasionuarve pas motorit [Vespa](#).

Me 29 maj, mbi 250 shtetas nga e gjithë bota, udhëtuan mbi 700 km (Bari-Durres-Sarande-Tiranë) me motorin e veçantë Vespa, ku dhe patën mundësinë të eksplorojnë bukuritë e rralla natyrore, që ofron vendi ynë.

Ky aktivitet ishte një bashkëpunim i [Vespa Club Tirana](#) & [Vespa Club Bari](#) dhe u mundësua falë mbështetjes së Sigal Uniqa Group Austria.

Kjo nuk është hera e parë që kompania SIGAL UNIQA Group Austria mbështet evente social-kulturore. Për vite me radhë, që prej themelimit, SIGAL ka mbështetur artistë dhe sportistë, ka promovuar Shqipërinë në Europë dhe nëpër botë, ka kontribuar në ndërtimin dhe restaurimin e veprave kulturore dhe trashëgimisë kombëtare etj.

“Mbrotjtja e të dhënave personale”

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjtjen e të Dhënave Personale në datat 3-4 maj 2018 organizoi Konferencën e Autoriteteve Evropiane të Mbrotjtjes së të Dhënave, me temë “Mbrotjtja e të dhënave – së bashku më mirë” (*Conference of European Data Protection Authorities: Data Protection – Better Together*), edicioni i 28-të.

Ky është aktiviteti më i rëndësishëm në këtë fushë në kontinentin evropian dhe zhvillohet për herë të parë në Shqipëri dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Ky aktivitet u mbështet nga SIGAL UNIQA Group Austria në kuadër të përgjegjësisë sociale të kompanisë, sikundër ka mbështetur me dhjetëra aktivitete të fushave të ndryshme përgjatë viteve.

“Festojmë për Gjergj Kastriotin”

Në kuadrin e vitit mbarëkombëtar të Gjergj Kastriot Skënderbeu-t, u organizua në Kepin e Rodonit koncerti "Festojmë për Gjergj Kastriotin" në datën 10 maj.

Pjesë e rëndësishme e këtij eventi ishte dhe pjesëmarrja e veçantë e Orkestrës së Harqeve e Klubit të Artit e Kulturës SIGAL UNIQA, e cila u prezantua me një program të pasur artistik, ku veçojmë pjesë nga Opera "Bijtë e Skënderbeut", të kompozitorit Abdulla Grimci, suitë me këngë arbereshe,etj.

Udhëheqës artistik Z. [Ermir Dizdari](#) (Mjeshtër i Madh).

Të dhënat nga AMF, SIGAL UNIQA udhëheq tregun

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA është e para në tregun e sigurimeve, me rreth 30% të tregut.

Nga të dhënat e publikuara nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare për muajin janar-prill 2018, SIGAL UNIQA vazhdon të udhëheqë tregun duke zotëruar përkatësisht:

62.91% të volumit të përgjithshëm të primeve për Sigurimin e Jetës;

27.81% të volumit të përgjithshëm të primeve për sigurimin e Jo-Jetës

22.01% të volumit të përgjithshëm të primeve për Sigurimet Motorike;

46.85% të volumit të përgjithshëm të primeve në Sigurimin e Pasurisë;

31.00% të volumit të përgjithshëm të primeve në Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim për shoqëritë Jo-Jetë.

50.00% të volumit të përgjithshëm të primeve në Sigurimin e Përgjegjësisë Civile

49.26% të volumit të përgjithshëm të primeve në Sigurimin e Garancive



Sipas AMF, tregu rezulton me një rritje prej 3.34% më shumë se në janar—prill 2017. Primet bruto kapën shifrën mbi 4,894 milionë lekë. Numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 356,630 me një rritje prej 6.07% krahasuar me janar-prill 2017.